



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo

01.Nr. 400/01-6464/26

Zyra e Kryetarit



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipality of Kaçanik

Datë: 18.03.2026

Në mbështetje të Nenit 17 pika h dhe pika r, Nenit 58 pika h të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, dhe Rregullorës MF-NR-04/2017 MBI KRITERET, STANDARTET DHE PROCEDURAT E FINANCIMIT PUBLIK TË OJQ-VE dhe Rregullorës Komunale Nr.06/2016 për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve si dhe në bazë të Nenit 73 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, Kryetari i Komunës merr këtë :

## VENDIM

### PËR LEJIMIN E MJETEVE FINANCIARE

1. LEJOHET ndarja e mjeteve financiare nga kategoria e Subvencioneve dhe Transfereve në fushën e Kulturës në shumën prej 28,000.00 € për vitin 2026 .
2. U lejohet shuma e mjeteve financiare OJQ-ve Kulturore si në vijim :

1	NGO Camp of Mural Artist/.OJQ Kampi I Artistëve Mural	The House of Creative -Edition III	3,750.00 €
2	Shoqëria Kulturo Artistike Gryka e Kaçanikut	Aktivitetet e OJQ-së për vitin 2026	9,900.00 €
3	Shoqëria Kulturore Artistike Tingujt e Vendëlindjes	Promovimi në Festivale, Java Diasporës, Shënimi i Datave të Rëndësishme në Kaçanik	4,500.00 €
4	Qendra Kulturore "Kaçaniku"	Organizimi I Festivalit Kombëtar të Shkave dhe Ansambleve Kulturore Artistike,	9,850.00 €
Totali			28,000.00 €

3. Mjetet Buxhetore nga ky vendim sigurohen nga programi buxhetor i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, përkatësisht nga kategoria buxhetore Subvencione dhe Transfere.

4. Ky vendim bëhet i plotëfuqishëm me rastin e nënshkrimit.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të përkujdesen : Drejtorja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit si dhe Drejtorja e Buxhetit dhe Financave.

6. Vendimi i dërgohet Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave si dhe arkivit komunal.

